



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U “Nënë Tereza” kërkon të punësojë **1(një)** punonjës në pozicionin **Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve Ligjore, pranë Drejtorisë Juridike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”**.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:

- Arsimit i lartë, profili Juridik. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Preferohet të ketë eksperiencë pune në fushën e marrëdhënieve ligjore, përparësi do të kenë ata kandidatura që kanë Licencën e Avokatisë;
- Njohuri shumë të mira të kuadrit ligjor në fuqi në përgjithësi e veçanërisht të përfaqësimit në procese gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyqësorit;
- Të ketë njohuri shumë të mira të procedurave administrative;
- Aftësi dhe fleksibilitet në përditësimet e ndryshimeve ligjore;
- Aftësi për të respektuar afatet;
- Të zbatojë në mënyrë rigoroze detyrat e ngarkuara;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.

Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentata në gjuhën shqipe si më poshtë:

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV) në gjuhën shqipe ku të jetë edhe adresa e postës elektronike (e-mail)
3. Diploma/t e arsimit të lartë, të noterizuar/a
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Formulari i Vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore (link: <http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/>)
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU “Nënë Tereza” duke nisur nga data **13.10.2022 ora 08:00 deri më 27.10.2022 ora 16:30.**

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE